



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES**

VENDIM

Nr. 33, datë 28.10.2025

**PËR
MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI
NË VENDIMIN E KËSHILLIT DREJTUES NR. 19, DATË 29.08.2013 “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS DHE NUMRIN
E PUNONJËSVE NË AGJENCINË E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE”, I
NDRYSHUAR**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 52 pika 1, shkronja “ë” të Ligjit nr.53/2014 datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 6, pika 2, shkronja “p” dhe të nenit 9, pika 3 të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, miratuar me vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 6/1, pika 1, shkronja “e” të Rregullores “Për nënshkrimet e autorizuara në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar, të nenit 18 Rregullores nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit Drejtues nr. 19, datë 29.08.2013 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe numrin e punonjësve në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar, të bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në Aneksin 2 “Organika dhe përshkrimet e vendeve përkatëse të punës”, përshkrimi i punës për pozicionin “Zëvendës drejtor i Përgjithshëm”, zëvendësohet me aneksin me të njëjtin titull dhe numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.





3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shqipe Malaj

Sekretare

Donald Duraj

Kryetar

